

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “UNLIMITED CONSTRUCTIONS” SHPK.

Ne Tirane, sot me date 02.03.2022 Aksioneri i vetem: **Z. Ermir Ndreaj** me shtetesi dhe kombesi shqiptare, i biri i Rrustem dhe Fahrie, lindur me 17-08-1981 ne Bajram Curri, Tropojë dhe banuese ne Tirane, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me karte identiteti me nr, leternjoftimi 032927418 dhe nr. Personal I10817062P.

Te cilet hartojne kete Akt Themelim te shoqerise “UNLIMITED CONSTRUCTIONS”, me emer Tregetar **“UNLIMITED CONSTRUCTIONS” SHPK** mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007“ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “UNLIMITED CONSTRUCTIONS” SHPK, me emer tregtar **“UNLIMITED CONSTRUCTIONS” SHPK** eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti Juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi te jete rregjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj.

Shoqeria pasi te kete fituar Personalitetin Juridik eshte perjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj. Shoqeria **“UNLIMITED CONSTRUCTIONS” SHPK** eshte nje shoqeri qe themelohet ndermjet ortakeve qe perballojne humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia e shoqërisë



Selia e shoqërisë është, Njesi Tregtare/Dyqan Nr. 11, e ndodhur ne shkallen A, ne katin perdhe me akse G,I:5,6 me sipërfaqe totale 106,4 m² ne kryqezimin Blv. "Gjergj Fishta" me Rr. e Kavajes, Njesia Nr. 7 Tirane, Shqipëri.

Veprimitaria e shoqërisë do te zhvillohet ne tërë territorin e Republikës së Shqipërise, mund te ndryshoje seline e saj , mund te hape adresa dytesore. Shoqëria mund te cële degë dhe zyra përfaqesimi të reja jashtë territorit te Republikës se Shqiperisë. Ato hapen dhe prishen me vendim te të Asamblesë së Pergjithshme të saj.

Neni 4 Objekti i shoqërisë

4.1 Objekti i shoqërisë në përputhje me legjislacionin aktual tregtar shqiptar do të jetë: Aktivitet sherbimi ,ne fushen e ndertimit dhe projektimit, import , eksport dhe tregeti materjale ushqimore etj. Punime germimi ne toke, prishje ndertesa civile dhe industriale, Rikonstukcion dhe mirembajtje godinash civile e ifrastrukturë, veshje fasada, Rruga, autostrada, mbikalime, hekurrudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, Punime nentokesore, ura vepra arti, Diga dhe tunele hidroteknike, Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, Punime dhe mrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime, Ndertim i impiateve per prodhimin e energjise elektrike. Aktivitet ne fushen e ndertimit dhe projektimit. Punime germimi ne toke, Ndërtim civile dhe industriale, Rikonstukcion dhe mirembajtje godinash civile e ifrastrukturë, veshje fasada, Rruga, autostrada, mbikalime, hekurrudha, tramvai, metro, pista aeroportuale, Punime nentokesore, ura vepra arti, Diga dhe tunele hidroteknike, Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, Ndertime detare dhe punime thellimi ne uje, Punime dhe mrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime, Ndertim i impiateve per prodhimin e energjise elektrike. Tregtim me shumice dhe pakice. Import- eksport, tregtim te materialeve te ndryshme, tregtim produktesh te gatshme dhe gjysem te gatshme, me shumice dhe pakice, tregtim artikuj sportive dhe argetimi, materiale kancelarie, transport dhe tregtim te produkteve bujqesore e blegtoriale, fruta-perime si edhe mallra te tjere ushqimore. Autoservis, tregtim te makinerive te ndryshme e pjese kembimi per to. Sherbime pastrimi dhe mirembajtjeje, te ambienteve te brendshme dhe te jashtme, industriale dhe civile, publike dhe private, reklamave e totemeve te ambienteve spitalore, qendrave shendetesore, qendrave tregtare, hoteleve, zyrave, universiteteve, marketeve, bankave, bar-restoranteve, portheve, aeroporteve, terminaleve etj. Shoqeria do te ushtroje cdo aktivitet ndihmes ne perputhje me legjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.

Neni 5 Kohëzgjatja e shoqërisë



Kohëzgjatja e shoqërisë “**UNLIMITED CONSTRUCTIONS**” SHPK është pa afat dhe fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve ligji tregtar për ndryshimin e statutit.

KAPITULLI - II KAPITALI , KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 6 Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njeqind mijë) i ndare ne 1 (nje) kuote. Pronësia mbi kapitalin të shoqërisë është si më poshtë:

1. Ortaku i vetem **Z Ermir Ndreaj**, eshte zoteruese e nje kuote ne vlore 100.000 leke , qe perben 100% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë,ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar,si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3(tre)vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7 Menyra te fitimit dhe Kalimit te Kuotave

Kuota te kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a)kontributit në kapitali ne shoqërisë;
- b)shitblerjes;
- c)trashëgimisë;
- ç)dhurimit;
- d)çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

- 1..Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë,kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 2.Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave,veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
- 3.Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë,kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën,si dhe kushtet e tjera të kalimit,përfshirë momentin e pagesës së



çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8 **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh)mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotavedhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin ne çfaredo banke apo institucion financier.
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9



Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga një Administrator Ermir Ndreaj i cili sipas statutit dhe ligjit emerohet per një periudhe 5 - vjecare me te drejtë riperteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoren në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorja shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkësë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person jashtë ortakerise.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të te gjitha shkallevë, prokurorive te te gjitha shkallevë, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoritetet Doganore etj, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.



Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 12
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 13
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permabjtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen shqipe, u

miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "**UNLIMITED CONSTRUCTIONS SHPK**", nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ortaku themelues

te shoqerise "**UNLIMITED CONSTRUCTIONS SHPK**"

ERMIR NDREAJ

